

VENDIM
Nr. 1077, datë 11.4.2019

PËR REZULTATIN E ZGJEDHJEVE DHE SHPALLJEN E FITUESIT

Në mbështetje të nenit 115, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni i Votimit, me përbërje:

Anila Leka: kryetare;

Adnan Xholi: anëtar;

Arben Kraja: anëtar,

pasi administroi gjithë dokumentacionin e votimit, numëroi votat, përpiloi procesverbalin përkatës

VËREN:

Në përfundim të procesit të votimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve për zgjedhjen e 1 (një) prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, rezultoi se morën pjesë në votim 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë) prokurorë, nga të cilët votuan pro kandidatit z. Vatë Staka 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) prokurorë, ndërsa 81 (tetëdhjetë e një) vota janë të pavlefshme.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenin 115, paragrafët 5 e 7, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nenit 15, të rregullores së Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve, Komisioni i Votimit

VENDOSI:

1. Të shpallë fitues prokurorin e Prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë, Vatë Staka.
 2. Ky vendim të shpallet zyrtarisht në faqet zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme jo më vonë se 24 orë nga mbyllja e Mbledhjes së Përgjithshme.
 3. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.
- Tiranë, më datë 11.4.2019, ora 13:20.

KOMISIONI I VOTIMIT
KRYETARE
Anila Leka
ANËTARË
Adnan Xholi, Arben Kraja